

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me sekretaren juridike Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.K., nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, P.nr.483/2017, të dt.07.06.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.08.2019, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të akuzuarit J.K., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, P.nr.483/2017, të dt.07.06.2019, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, P.nr.483/2017, të dt.07.06.2019, është shpallur fajtor i akuzuari J.K., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPK dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 60(gjashtëdhjetë) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit në kuptim të nenit 47 të KPK, i është zëvendësuar në dënimin me gjobë në shumën prej 300Euro, të cilin dënim është obliguar që të paguaj në afat prej 3(tre) muajve, në tri këste mujore, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim, në kohëzgjatje prej 15 ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 Euro.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale, në shumën prej 20 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt civilo juridik.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari J.K., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë, ose dënim me kusht ose në rastin më të parë volitshëm çështja penale të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.986/2019, të datës 14.08.2019, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit J.K., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar nga ana e të akuzuarit, të propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e të akuzuarit J.K., nuk është e bazuar**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar në masë të duhur të gjitha rrethanat lehtësuese dhe se nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore, përkitazi me zbutjen e dënimit dhe kufijtë e zbutjes të paraparë në neni 75 dhe 76 të KPK, andaj, ka propozuar që ti shqiptet një dënim më i butë, të lirohet nga fajësia, ose ti shqiptohet dënimi me kusht, apo në rastin më të pa volitshëm çështja penale të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimin e ankimuar së bashku me shkresat e lëndës dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila rezulton edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, të cilën rrethanë së bashku me rrethanat e tjera, gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 73 të KPK, i ka vlerësuar, e sidomos ka pasur parasysh edhe rrethanat e tjera se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet efekti dhe qëllimi i të njëjtit, pasi që me këtë lloj dënimi do të parandalohet që në të ardhmen mos të kryej vepra të reja penale, gjithashtu kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar edhe ankesën e të akuzuarit nga e cila nuk ka gjetur ndonjë rrethana posaçërisht lehtësuese për ta konsideruar me marrjen e një vendimi tjetër, andaj, në prani të këtyre rrethanave, përkatësisht pas vlerësimit të aktgjykimit të ankimuar, ankesës së ushtruar si dhe shkresave tjera të lëndës, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.970/19 të datës 27.08.2019**

**Sekretare juridike,**  
**Fitnete Hoti**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetar i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Biljana Rexhiq**